



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2023:223740  
Datë: 29.05.2024  
Numri i dokumentit: 05753522

KPPP.nr.1684/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “MORAVAMONT”, me seli në Gjilan, me NUI: 810522111, kundër debitorit “TECHNOBURIMI”, me seli në Mitrovicë, me NUI: 810548307, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit P.nr.629/23 të datës 05.09.2023, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Kushtrim Musa me seli të zyrës në Gjilan, jashtë seancës, me datë 24.05.2024, mori këtë:

**AKTVENDIM**

- I. APROVOHET ne tërësi i bazuar prapësimi i debitorit “TECHNOBURIMI”, ashtu që SHFUQIZOHET Urdhri P.nr.629/23 i datës 05.09.2023, i lëshuar nga Përmbaruesi Privat Kushtrim Musa.

**A r s y e t i m**

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrin P.nr.629/23 të datës 05.09.2023, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumenteve të besueshme – faturave dhe atë: faturës nr.09/2023 të datës 04.09.2023, faturës nr.08/2023 të datës 01.08.2023, faturës nr.07/2023 të datës 04.07.2023, faturës nr.06/2023 të datës 06.06.2023, faturës nr.05/2023 të datës 03.05.2023, faturës nr.04/2023 të datës 03.04.2023, faturës nr.03/2023 të datës 01.03.2023, faturës nr.02/2023 të datës 07.02.2023, faturës nr.01/2023 të datës 04.01.2023,

faturës nr.12/22 të datës 01.12.2022, faturës nr.11/22 të datës 01.11.2022, faturës nr.10/22 të datës 03.10.2022, faturës nr.09/22 të datës 01.09.2022, faturës nr.08/22 të datës 01.08.2022, faturës nr.07/22 të datës 01.07.2022, faturës nr.06/22 të datës 01.06.2022, faturës nr.05/22 të datës 04.05.2022, faturës nr.04/22 të datës 01.04.2022, faturës nr.03/22 të datës 01.03.2022, faturës nr.02/22 të datës 01.02.2022, dhe faturës nr.01/22 të datës 05.01.2022, duke e obliguar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri t'ia paguaj kreditorit shumën prej 247,800.00 Euro, me kamatëvonesë prej 8 % në vit nga dita e lejimit të këtij propozimi deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet procedurale, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër Urdhrit të Përmbaruesit Privat, brenda afatit ligjor debitori ka paraqitur prapësim, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me arsyetimin se faturat nuk kanë elementin kryesor-pranimin e faturave. Ka shtuar se për shkak të gjendjes faktike një obligim i tillë nuk qëndron, sepse ka rritje të faturave sipas kontratës mbi qiranë me nr.05/2020 të datës 01.07.2020, ku në nenin 2 të kësaj kontrate është i cekur çmimi prej 10,000.00 Euro, dhe në nenin 4 të kësaj kontrate është e cekur që nuk ka barrë tatimore tjetër. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri përmbarimor i Përmbaruesit Privat.

Kreditori, në përgjigje në prapësim, ka deklaruar se kreditori procedurën përmbarimore e ka inicuar në bazë të faturave të cilat i plotësojnë kushtet ligjore sipas LPP-së, për faktin se faturat janë origjinale dhe me të gjitha elementet që duhet t'i ketë një faturë sipas ligjit, nuk kemi pasur asnjë vërejtje nga ana e debitorit, si dhe faturat e tilla janë dërguar në e-mailin zyrtar të debitorit. Më tej ka theksuar se debitori e pranuar vet se obligimi mujor ndaj kreditori është në shumë prej 10,000.00 Euro, ndërsa TVSH 18 % nuk është shumë që e gëzojmë kreditori, por është tatim mbi vlerën e shtuar, andaj obligimi i çdo muaji faturohet 11,800.00 Euro (10,000.00 Euro qeraja mujore + 18 % TVSH-1,800.00 Euro). I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit, ndërsa të vërtetohet si i bazuar urdhri për lejimin e përmbarimit, si dhe të obligohet debitori të paguaj shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim prej 325.00 Euro sipas TA të MD-së.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës,

si dhe duke i'u referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par.2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 paragrafit 1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”* dhe me paragrafin 3 të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”.*

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Gjykata gjeti se fatura nr.09/2023 e datës 04.09.2023, fatura nr.08/2023 e datës 01.08.2023, fatura nr.07/2023 e datës 04.07.2023, fatura nr.06/2023 e datës 06.06.2023, fatura nr.05/2023 e datës 03.05.2023, fatura nr.04/2023 e datës 03.04.2023, fatura nr.03/2023 e datës 01.03.2023, fature nr.02/2023 e datës 07.02.2023, fatura nr.01/2023 e datës 04.01.2023, fatura nr.12/22 e datës 01.12.2022, fatura nr.11/22 e datës 01.11.2022, fatura nr.10/22 e datës 03.10.2022, fatura nr.09/22 e datës 01.09.2022, fatura nr.08/22 e datës 01.08.2022, fatura nr.07/22 e datës 01.07.2022, fatura nr.06/22 e datës 01.06.2022, fatura nr.05/22 e datës 04.05.2022, fatura nr.04/22 e datës 01.04.2022, fatura nr.03/22 e datës 01.03.2022, fatura nr.02/22 e datës 01.02.2022, dhe fatura nr.01/22 e datës 05.01.2022, në bazë të së cilave është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme, për faktin se faturat në rastin konkret janë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk janë pranuar nga debitori, përkatësisht nuk përmbajnë nënshkrimin e as vulën e pranuesit– debitorit.

Duke qenë se debitori nuk i ka pranuar në mënyrë të rregullt faturat e lartcekura, si të tilla nuk mund të shërbejnë si dokumente të besueshme dhe nuk kanë tipare të përmbartueshmërisë, përderisa njëra palë procedurale - debitori nuk ka pranuar detyrimin që rrjedh nga faturat.

Gjykata vlerëson se meqenëse kreditori nuk ka ofruar ndonjë provë nga e cila rezulton se pranimi i faturave konkrete është bërë në mënyrë të rregullt nga debitori, atëherë rezulton se faturat e lartcekura nuk mund të paraqesin bazë për lejimin e përmbarimit.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1684/23 me datë

24.05.2024

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.